



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 23.1.2023
Nr. Prot 367

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së KOMISIONIT RREGULLATOR

E nderuar Kryetare e Rregullatorit,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të paragrafit 1 të nenit 19 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni, se është përgatitur projektvendimi:

"Për rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në vendet e numërimit të votave dhe transmetimin në kohë reale nga vendet e numërimit të votave në ambientet e komisionit qendror të zgjedhjeve".

Bazuar në shkronjën "c", paragrafi 2, të nenit 20 të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, miratimi i këtij projektvendimi është kompetencë e Komisionit Rregullator.

Për këtë arsye propozoj thirrjen e mbledhjes për shqyrtimin e këtij projektakti.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimit dhe relacionit shoqërues.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

